

VENDIM
Nr.1300, datë 29.12.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË” NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE
TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, si më poshtë vijon:

a) “Tekstil dhe stilim mode”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në tekstil dhe stilim mode”;

b) “Planifikimi i sistemeve të transportit, menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në planifikimi i sistemeve të transportit, menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore”.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuotat e pranimeve në këto programe “Master i nivelit të parë”, në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2009-2010, të jenë, si më poshtë vijon:

a) Tekstil dhe stilim mode 25;

b) Planifikimi i sistemeve të transportit, menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore 25.

5. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, si më poshtë vijon:

a) Tekstil dhe stilim mode 60 000 lekë;

b) Planifikimi i sistemeve të transportit, menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore 75 000 lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

7. Kuotat e pranimeve në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, sipas pikës 4 të këtij vendimi, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha